

Nr. 10

2020

Studime Muzeologjike

Muzeu Historik Kombëtar



STUDIME MUZEOLGJIKE

Muzeu Historik Kombëtar



Studime Muzeologjike Nr. 10

Tiranë, 2020

© Të gjitha të drejtat janë të Muzeut Historik Kombëtar

Redaksia: Dr. Dorian Koci, Prof. Dr. Pëllumb Xhufi, Prof. Dr. Vaso Tole, Prof. Dr. Piro Misha, Dr. Ardit Bido, Dr. Skënder Bushi dhe Andrea Llukani

Arti Grafik: Ilir Gushe

Tel: +35542223977
www.mhk.gov.al

PASQYRA E LËNDËS

Fjalë përshëndetëse	5
Dr. Dorian Koçi Lufta për marrjen e garnizonit të Kotës dhe një objekt muzeal i gjeneralit italian Enriko Gotti	7
Etleva Demollari Muzeologjia shqiptare në vitet e socializmit	18
Prof. dr. Lida Miraj Epidamnos, Dyrrachion/Dyrrachium, Durrës - Greek, Roman and Byzantine Architecture of the city, in the view from the third millennium	32
Fjoralba Prifti 40 vjet - Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar	60
Mark Palnikaj Dokumenti i Shtjefën Gasprit, viti 1671	64
Dr. Ark. Restaurator Reshat Gega Baptisteri i Butrintit. Arkitektura, dhe të dhëna të reja në ecurinë funksionale	77
Dr. Skënder Bushi Pavijoni i Arkeologjisë në Muzeun Historik Kombëtar	88
Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj Zhvillimi i Luftës së Vlorës dhe roli i saj në çështjen kombëtare .	104

Ilirian Gjika

Sllanica, skela e panjohur e lumit Vjosa 121

Andrea Llukani

Ikonografët nga Samarina 127

Gentian Vokopola

Realizimi i skenës “Fjetja e Shën Marisë” në ikonografinë shqiptare 141

Klejdi Zguro, Berbis Islami

Dokumentimi dhe ndërhyrjet konservuese preliminare në mozaikun e zbuluar në kuadër të projektit “Restaurimi i xhamisë mbret dhe teqesë së helvetive”, Berat 168

Erilda Selaj

Emergjencat në muze: Siguria, konservimi dhe koleksionet në situatë pandemie 175

Maringlen Abedini

Muzika, Bethoveni në këndvështrimin e Fan Nolit 186

Dr. Dorian Koçi

Recensë për librin e Prof. Ass. Dr. Frederik Stamatit “Për flamujt e Muzeut Kombëtar” 193

Dr. Dorian Koçi

Recensë për librin e Prof. Ass. Dr. Bernard Zotajt “Epopeja e fitimtarëve” 197

Andrea Llukani

Recensë për librin “Historia e veprave të lavdishme dhe fitoreve kundër turqeve nga zoti Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Princi i Epirit” 201

IKONOGRAFËT NGA SAMARINA

Ikonografët nga Samarina kanë pikturuar nëpër disa kisha të Shqipërisë. 1-Kishën e manastirit të “Kryeengjëjve” në Dervişan të Dropullit; 2-Kishën e manastirit të “Shën Pjetrit dhe Pavlit” në Zhymë të Myzeqesë; 3-Kishën e “Shpërfytyrimit” në Gjirokastrë; 4-Kishën e manastirit të “Qirjakut dhe Julitës” në Dhuvjan, Gjirokastrë, 5-Kishën e “Profetit Ilia” në Sopik të Pogonit, 6-Kishën e “Shën Mërisë” në Elbasan, 7-Kishën e “Ungjillëzimit” në Tiranë etj. Ikonografët nga Samarina i nënshkruanin punët e tyre: 1-nga katundi Samarinë, 2-Samaritanit, 3-nga Samarina 4-nga qyteti Samarinë etj.

Ndër piktorët ikonografë samaritanë mund të përmendim Dhimitrin dhe Harallambin, të cilët në vitin 1864 kanë pikturuar kishën e “Shën Pjetrit dhe Pavlit” në Zhymë të Myzeqesë¹. Zisi Mihali dhe Gjergji nga katundi Samarinë, më 3 qershor të vitit

¹ Mbi portën veriore të kishës gjendet një mbishkrim, i cili tregon kohën e pikturimit të kishës: “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i apostujve të shenjtë e të lavdëruar Pjetrit dhe Pavlit, në kohën e peshkopatit të gjithhirshmit dhe mitropolitit të Beratit, zotit Anthim, në kohën e priftëritit të Janit, me kontributin dhe në kohën e kujdestarisë së Tushit, dhe Naumit, Mihalit, me dorën e Dhimitrit dhe Harallambit, nga qyteti Samarinë, 1864, shkurt 27. Marku, Stefani dhe Theodori dhe Gjergji”. Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 246, faqe 137.

1869 kanë përfunduar së pikturuari kishën e manastirit të “Kryeengjëjve” në Derviçan të Dropullit². Adham Kristo Samaritani ka pikturuar ikonën e “Shën Gjergjit të Janinës”, që gjendet në kishën e manastirit të “Kryeengjëjve” në Derviçan. Mbi ikonë është shkruar: Me dorën e A. Dham Kristo Samaritanit³. Ikonografi Adham Kristo ka pikturuar edhe në kishën e “Profetit Ilia” në Sopik të Pogonit. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi mbi ikonën e “Shën Ilisë”: “1864 nëntor 13. Me dorën e A. Kristos nga Samaritana”⁴.

Mattheu Dh. Nga Samarina ka pikturuar ikonën e “Shën Gjergjit të Janinës”⁵, që ka qenë në kishën e “Shpërfytyrimit” në Gjirokastër. Mbi ikonë është shkruar: “Me dorën e Mattheut Dh. nga Samarina 1864, mars 12”⁶. Ikona identifikohet me numër inventari 5524 dhe përmasa 31x23 cm dhe aktualisht gjendet në

² Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim i pikturuar në apsidë në kungën e kishës: “Nga igumen arkimandrit Makari i manastirit të hirshëm të Taksiarkëve dhe me shpenzimet e të ndierit Gjergji Ndiriços Derviçanasit, 1869 qershor 3. Dora e Zisi Mihalit dhe e Gjergjit nga katundi Samarinë”. Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë, 1998, nr. 743, faqe 279.

³ Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë, 1998, nr. 740, faqe 278.

⁴ Dhimitër Beduli, Kishë dhe Kulturë, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 83; Dhimitër Beduli, Një vështrim mbi kishat dhe manastiret e Pogonit, Tiranë 1996, faqe 23.

⁵ Shën Gjergji paraqitet i veshur me fustanellë të gjatë, një pëllëmbë nën gju, me jelek e xhamadan, me gajtana të qëndisur, me skufi të kuqe në kokë, me një tufë të zezë nga pas dhe me opinga me xhufka përpjetë. Në dorën e djathtë shenjtji mban kryqin dhe në të majtën ka një pergamen të shkruar në greqishten bizantine. Në këmbë ka kallçe dhe ka mbathur opinga me xhufka përpjetë. Në anën e majtë të ikonës paraqitet skena e martirizimit të shenjtit. Në pjesën e sipërme të ikonës duken bedenat e kalasë së Janinës. Mbi bedena qëndrojnë disa ushtarë turq, të cilët mbajnë heshta në duar. Në qendër të ikonës paraqitet kulla e sahatit dhe mbi të është shkruar në greqishten bizantine “Shën Gjergji martir i ri nga Janina”. Nga pjesa qendrore e mbishkrimit zbresin rreze drite dhe nën to një kandil i ndezur. Nga lart, gjithashtu zbret një engjëll, i cili i ofron shenjtiti kurorën e martirit; Moikom Zeqo, *Pasaporta arkeologjike e traditave*, Arnissa Edition, Tiranë, 2010, faqe 85; Andrea Llukani, *Paraqitja e Shën Gjergjit të Janinës me fustanellë shqiptare*, Studime Muzeologjike nr. 6, Tiranë 2016, faqe 70-75.

⁶ Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë, 1998, Nr.739, faqe 278.

fondet e Muzeut Historik Kombëtar. (Fig.1) Një ikonë pothuajse e ngjashme është në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë. (Fig.2) Gjatë punës hulumtuese studimore në fondet e Muzeut Historik Kombëtar kemi arritur të evidentojmë edhe një ikonë tjetër, e cila mban autorësinë e Matheut nga Samarina. Ikona “Shën Mëria me Krishtin”, e cila ka mbishkrimin: “Me dorën e Matheut nga qyteti Samarinë”. Ikona evidentohet me nr. inventari 5601 dhe ka përmasat 41x78 cm. (Fig.3) Piktori më i shquar i artit të ikonografisë në Samarinë mbetet Mihal Anagnosti.

Veprimtaria e Mihal Anagnostit dhe e pasardhësve të tij shtrihet kryesisht në gjysmën e parë të shek. XIX. Mihal Anagnosti ka lindur në Samarinë, një fshat vlllehësh në Grebena të Greqisë. Burimi i vetëm për të ndjekur ecurinë ikonografike të Mihal Anagnostit dhe të bashkëpunëtorëve⁷ të tij, janë mbishkrimet kishtare. Aktiviteti ikonografik i Mihal dhe Dhimitër Anagnostit për herë të parë u shfaq më 1811, në vendlindjen e tyre, në Samarinë, ku ka pikturuar ikonën e “Shën Mërisë” në ikonostasin e kishës “Fjetja e Hyjllindëses”. Në ikonë është shkruar: “U pikturua ikona e shenjtë e Hyjllindëses me dorën e Mihal Anagnostit birit të Dhimitrit 1811”. Duke u nisur nga mënyra e realizimit mund të mendojmë se e të njejtës autorësi është edhe ikona e “Krishtit Pandokrator”. Në vitin 1815 Mihal Anagnosti ka pikturuar ikonën e “Shën Mërisë” në ikonostasin e kishës së “Shpërftyrimin të Shpëtimtarit”. Mbi ikonë është mbishkrimi: “Me dorën e Mihal Anagnostit birit të Dhimitrit nga Samarina 1815”. Në vitin 1817 Mihal Anagnosti ka pikturuar ikonën e “Krishtit Pandokrator” në ikonostasin e kishës “Shën e Premte” të Konicës. Në ikonë është shkruar: “Me dorën e Mihal Anagnostit nga Samarina, 3 gusht 1817”. Më 1819 Mihal Anagnosti, i ndihmuar nga biri i tij Dhimitri dhe nga papa Joani, që mendohet të ketë qenë vëllai i tij, kanë

⁷ Sipas traditës bashkëpunëtorët e piktorit ikonograf zakonisht qenë pjesëtarët e familjes së tij. Gjithashtu kemi edhe ndimësat, që nuk kishin lidhje farefisnore me ikonografin. Prindërit i shpinin bijtë e tyre pranë këtyre mjeshtërve që të mësonin artin e ikonografisë pa shpërblim. Mjeshtri kujdesej vetëm për ushqimin dhe fjetjen e nxënësve të tij.



Fig.1. Mattheu Dh. nga Samarina. Shën Gjergji i Janinës. (© Fondi i Muzeut Historik Kombëtar)



Fig.2. Mattheu Dh. nga Samarina. Shën Gjergji i Janinës. (© Muzeu i Artit Mesjetar Korçë)



Fig.3. Mattheu Dh. nga Samarina. Shën Mëria. (© Fondi i Muzeut Historik Kombëtar)

pikturuar afresket e kishës së “Shpërftyrimit të Shpëtimtarit” në Samarinë të Grebenasë në Greqi⁸. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi:⁹ “Me dorën e shpresëtarëve Dhimitër dhe Mihal Anagnostit dhe papa Joanit nga i njejti vend Samarina. U përfundua më 15 tetor të vitit shpëtimtar 1819, për lavdi të Perëndisë së shenjtë”.

Në manastirin e “Apostujve të Shenjtë” në Kalabaka të Greqisë kanë punuar Mihali dhe Dhimitri. Ky fakt vërtetohet nga një mbishkrim mbi portën e hyrjes: “Me dorën e shpresëtarit dhe mëkatarit Mihal Dhimitër Anagnostit nga Samarina, në muajin dhjetor u përfundua lavdi Perëndisë së Shenjtë”. Ndonëse nga mbishkrimi nuk e mësojmë vitin e pikturimit nga shkaku i dëmtimeve, duke u nisur nga emri i episkopit, që përmendet në mbishkrim dhe i personave të tjerë studiuesit kanë përcaktuar si kohë të pikturimit të kishës vitin 1820. Më 1821 Mihali nënshkruan emrin e tij në ikonën e “Shën Mërisë” mbi të cilën ka shkruar: “Me dorën e Mihal Anagnostit nga Samarina 1821”. Po në vitin 1821 Mihali ka pikturuar afresket në kishën e “Shën e Premtes” në Samarinë. Në afreskun e “Krishtit Pandokrator” në kupolën e kishës Mihali ka lënë mbishkrimin: “Në vitin shpëtimtar 1821 nga Adami 7330”. Duke ndjekur radhën kronologjike të krijimtarisë së Mihal Anagnostit na del se në vitin 1826 ka pikturuar kishën e “Shën Gjergjit” në Nigrita. Po këtë vit ka pikturuar kishën e “Shën Dhimitrit” në Bitola. Nën skenën “Deisis” ai ka nënshkruar: “Me dorën e shpresëtarit piktor Mihal Anagnostit nga Samarina”. Gjithashtu, më 1821 ka pikturuar ikonën e “Krishtit Pandokrator” në manastirin Treskavec.

⁸ Nikolaos Hroni Papageorgiou, *To katholiko tis Agias Paraskevis kai o naos tis Metamorfoseos tou Sotiros Samarinas Grebenon*, Kentro Bizantinon Erevnon, Thessaliniki, 2010, faqe 269.

⁹ Nga mbishkrimi mësojmë se pikturimi i kishës u bë nga piktorët Dhimitër dhe Mihal Anagnosti të ndihmuar nga papa Jani Anagnosti. Studiuesi Papageorgiou është i mendimit se “Papa Jani Anagnosti” është shtuar më vonë. Ndërsa studiuesi Kiço Makris është i mendimit se kisha është pikturuar nga vëllezërit Dhimitër dhe Mihal Anagnosti të ndihmuar nga Anagnosti Papajoani, pra emri i ikonografit është Anagnost dhe mbiemri Papajoani. Nikolaos Hroni Papageorgiou, *To katholiko tis Agias Paraskevis kai o naos tis Metamorfoseos tou Sotiros Samarinas Grebenon*, Kentro Bizantinon Erevnon, Thessaliniki, 2010, faqe 84.

Ikonat e Mihal Anagnostit në muzetë e Shqipërisë

Më 1828 Mihal Anagnosti ka pikturuar ikonat e ikonostasit të kishës së “Shën Mërisë” në Elbasan. Aktualisht ikonat janë të ekspozuara në pavijonin e ikonave pasbizantine të Muzeut Historik Kombëtar. Ikona e madhe e “Krishtit Pandokrator”¹⁰ (Fig.4) është

¹⁰ Në ikonë Krishti Pandokrator paraqitet me lavdinë e Tij qiellore. Ai është veshur me rroba të kuqe dhe me tunikën ngjyrë blu. Stihari i Krishtit është i stolitur me motive floreale. Në mes ka lidhur një rrip ngjyrë ari. Në prehër mban Ungjillin. Krishti bekon me dorën e djathtë dhe mban globin e gjithësisë në dorën e majtë. Mbi glob është një kryq ngjyrë ari. Ungjilli i Shenjtë tregon se Jisu Krishti është mësues për gjithë njerëzimin. IC XC në pjesën e sipërme të ikonës janë shkronjat e para të emrit Jisu Krisht në greqisht. Të përkthyer në shqip, mund të shkruhen JS KR. Shkronjat në kurorën Ì Û Í kanë kuptimin “AI QË ËSHTË”. Përkthyer në shqip, mund të shkruhen “JAM”. Ky është emri që Zoti i tregoi Moisiut në Malin e Horebit. Në gjuhën hebraike nuk ekziston folja *jam*. Prandaj, kur hebretë donin të thoshin *ky është Krishti*, ishin të detyruar të thoshin *Jisu Krishti* dhe me këtë kuptonin se Jisui ishte Krishti. Jisu Krisht për të krishterët hebrej ishte një thënie që tregonte besimin e tyre. Kur thoshin Jisu, ata nënkuptonin personin dhe kur thoshin Krisht, nënkuptonin Perëndinë. Në pjesën fundore të ikonës është shkruar emri i murgeshës Anisia, e cila ka financuar ikonën: “Lutje e shërbëtores së Perëndisë, murgeshës Anisias. 1828”. Hitoni i Krishtit është realizuar duke iu shmangur trajtimit të mënyrës bizantine të drapërinjve. Ai trajtohet i lirshëm, duke i pikturuar figurat ikonografike me veshje të mëndafshita. Palat e veshjeve janë shumë të natyrshme. Ato lejojnë të dallohet qartë qëndrimi anatomik i trupit. Në anën e djathtë të ikonës është shkruar emri i ikonografit: “Me dorën e Mihal Anagnostit nga Samarina”. *Mostra di icone albanesi*, Roma, Vicolo Valdina, 6-24 febbraio / 8 marzo 1998; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.79, faqe 77; Ylli Drishti, *Ikona, Koleksioni i Muzeut Historik Kombëtar (Shek.XIV-XIX)*, Konsulent shkencor Andrea Llukani, Botimet Mali Pleshti, Tiranë 2017, faqe 87; Ylli Drishti, *Icons, Colection of the National History Museum (14th-19th centuries)*, Scientific advisor Andrea Llukani, Mali Pleshti, Tirana 2017, page 87; Andrea Llukani, *Ikonat e Mihal Anagnostit në Muzeun Historik Kombëtar*, Studime Muzeologjike nr. 5, Tiranë 2015, faqe 53-55; Andrea Llukani, *Mihal Anagnosti, piktori i fundit i artit pasbizantin në Shqipëri*, Le Radici, Anno 13, n.3, Novembre 2015, pagina 23; Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, *Thesare të Muzeut Historik Kombëtar*, Tiranë, 2018, faqe 108-109; Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, *Treasuries of National Historical Museum*, Tirana, 2018, page 108-109.



Fig.4. Mihal Anagnosti. Krishti Pandokrator. (© Muzeu Historik Kombëtar)

piktuar prej Mihal Anagnostit nga Samarina: “Me dorën e Mihal Anagnostit nga Samarina”¹¹.

Në pavijonin e ikonave pasbizantine të Muzeut Historik Kombëtar janë disa ikona të pikturuara nga Mihal Anagnosti si edhe “Dyert e Bukura” të kishës së “Shën Mërisë” në Elbasan. Ikonat e mëdha janë: Krishti Pandokrator, me përmasat 103x73.5 cm dhe numër inventari 3691; Shën Mëria me Krishtin¹², me përmasat 101x75 cm dhe numër inventari 3693; Joan Pagëzori, me përmasat 101x77 cm dhe numër inventari 3690; Shën Gjergji, me përmasat 103x57 cm dhe numër inventari 3684; Shën Kollin, me përmasat 103x66.5 cm dhe numër inventari 3695; Shën Athanasi, me përmasat 103x68.5 cm dhe numër inventari 3688; Profeti Ilija, me përmasat 100x67 cm dhe numër inventari 3696; Dyert e Bukura, me përmasat 163.5x46.5 / 195x52 dhe numër

¹¹ Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.79, faqe 77.

¹² *Mostra di icone albanesi*, Roma, Vicolo Valdina, 6-24 febbraio / 8 marzo 1998.

inventari 3674 /1/2. Dyert e bukura janë gdhendur nga Petro Filipi dhe janë pikturuar nga Mihal Anagnosti. Gjatë punës hulumtuese në fonde kemi mundur të evidentojmë Dyert anësore. Kryeengjëlli Mihail, me përmasat 122x74.5 cm dhe numër inventari 5922 dhe kryeengjëlli Gabriel, me përmasat 122x74.5 cm dhe numër inventari 5937.

Në pavijonin e ikonave pasbizantine të Muzeut Historik Kombëtar janë edhe ikona të tjera me përmasa të vogla: Prerja e Pagëzorit, me përmasat 38 x 23.3 cm dhe numër inventari 3682¹³; Mandili i Krishtit¹⁴, me përmasat 38.2x29.5 cm dhe numër inventari 3700; Ipapandia, me përmasat 38.7x28.8 cm dhe numër inventari 3702; Pendikostia, me përmasat 37.5x27.9 cm dhe numër inventari 3703; Burimi jetëdhënës, me përmasat 38.7x28.4 cm dhe numër inventari 3704; Shën Kozmai dhe Damjani, me përmasat 38.5x29 cm dhe numër inventari 3705; E diela e miroprurëseve, me përmasat 38.5x29.5 dhe numër inventari 3706; Gjetja e kokës së Joan Pagëzorit, me përmasat 38x29 cm dhe numër inventari 3707; Shën Triadha, me përmasat 38.7x25.5 cm dhe numër inventari 3708; Mesipendikosti, me përmasat 39.2x28.6 cm dhe numër inventari 3709; Shën Kolli, Sava dhe Varvara, me përmasat 37.5x29 cm dhe numër inventari 3710; Darka mistike, me përmasat 38x29 cm dhe numër inventari 3711; E diela e ulokut, me përmasat 38.4x27.6 dhe numër inventari 3712; Mbledhja e apostujve, me përmasat 39x28.5 dhe numër inventari 3713¹⁵.

Gjatë punës hulumtuese për katalogimin e ikonave që janë në fondet e Muzeut Historik Kombëtar kemi mundur të evidentojmë

¹³ Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, *Thesare të Muzeut Historik Kombëtar*, Tiranë, 2018, faqe 110-111; Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, *Treasures of National Historical Museum*, Tirana, 2018, page 110-111.

¹⁴ Në ikonë është data 1828. *Mostra di icone albanesi*, Roma, Vicolo Valdina, 6-24 febbraio / 8 marzo 1998.

¹⁵ Andrea Llukani, *Ikonat e Mihal Anagnostit në Muzeun Historik Kombëtar*, Studime Muzeologjike nr. 5, Tiranë 2015, faqe 53-55; Andrea Llukani, *Mihal Anagnosti, piktori i fundit i artit pasbizantin në Shqipëri*, Le Radici, Anno 13, n.3, Novembre 2015, pagina 23.

mjaft ikona që kanë autorësinë e Mihal Anagnostit nga Samarina. Tematika e ikonave është e larmishme. Tre jerarkët, me numër inventari 5773; Shën Julita dhe Shën Marena, me numër inventari 5774; Ungjillor Mateu, Marku dhe Luka, me numër inventari 5770; Shën Stilian i Panflagonisë, Alipis Athoniti i Ri dhe Shën Kozmai, me numër inventari 5785; Shën Harallambi dhe Trifoni, me numër inventari 5786; Gjithë shenjtoret, me numër inventari 5802; Shën Eleanziari, Solomona dhe shtatë djemtë Makabenj, me numër inventari 5849; Rrethprerja e Krishtit, me numër inventari 6107; Dyzetë shenjtoret¹⁶, me numër inventari 6109; Hyrja në Jeruzalem, me numër inventari 6060; Shën Gjergji, me numër inventari 6121; Shën Athanasi i Madh, Kirili i Aleksandrisë dhe Eftimi i Madh, me numër inventari 6078; E diela e të verbërit, me numër inventari 6086.

Në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Ndër to mund të veçonim ikonat: “Shën Gjergji dhe Shën Dhimitri”¹⁷, “Shën Dhimitri”¹⁸,

¹⁶ *Mostra di icone albanesi*, Roma, Vicolo Valdina, 6-24 febbraio / 8 marzo 1998.

¹⁷ Ikona “Shën Gjergji dhe Shën Dhimitri” është pjesë e ikonave të mëdha të ikonostasit të kishës së Shën Mërisë në Elbasan. Ikona ka përmasat 98x75 cm dhe numër inventari nr. 40. Paraqitja e dy shenjtoreve strategë në një ikonë është rast i rrallë në ikonografinë bizantine. Shën Gjergji ka hipur mbi një kalë ngjyrë gri, me veshje ushtarake dhe me pelerinën e kuqe që i valvitet. Shën Gjergji godet me heshtë dragojn, që përpëlitet nën këmbët e kalit. Shën Dhimitri ka hipur mbi një kalë të kuq. Shenjti ka veshur veshje ushtarake. Nga pas i valvitet pelerina blu dhe me heshtën e tij ka goditur gladiatorin romak që është rrëzuar në tokë. Në pjesën e djathtë të ikonës paraqitet qyteti i rrethuar me bedena. Në hyrjen kryesore qëndron Elisabeta, që sipas legendës priste vdekjen e tmerrshme. Ylli Drishti, *Le icone albanesi XIII-XIX secolo*, Collezione della Galleria nazionale d’Arte Tirana, Tirana, 2000, page 118; Ylli Drishti, *Ikona shqiptare Shek. XIII-XIX*, Koleksioni i Galerisë Kombëtare të Arteve Tiranë, Tiranë, 2000, faqe 118.

¹⁸ Ikona “Shën Dhimitri” është pjesë e ikonave të mëdha të ikonostasit të kishës së Shën Mërisë në Elbasan. Ikona ka përmasat 101x67 cm dhe numër inventari nr. 37. Paraqitja e Shën Dhimitrit është me veshje ushtarake. Me dorën e djathtë mban një kryq, ndërsa dorën e majtë e ka të mbështetur tek milli i shpatës me këllëf të artë, duke mbajtur njëkohësisht një heshtë të mbështetur në supin e tij. Shenjti paraqitet në moshë të re. Potreti i tij rrethohet nga flokët e dendur ngjyrë kafe që i derdhen mbi supet. Mbi flokë, në pjesën ballore paraqitet një kryq i vogël që mbahet nga disa lidhëse të bardha. Veshja është realizuar me ngjyra të ngrohta dhe është zbukuruar me motive floreale

“Shën Kostandini dhe Elena”¹⁹, etj.

Mihal Anagnosti e trashëgoi traditën e pikturimit të ikonave tek djali i tij, Dhimitri. Në vitin 1830 ata kanë pikturuar së bashku në ikonostasin e kishës së “Ungjillëzimit” në Tiranë ikonën e “Krishtit Pandokrator”²⁰

të stilizuara. Ylli Drishti, *Le icone albanesi XIII-XIX secolo*, Collezione della Galleria nazionale d'Arte Tirana, Tirana, 2000, page 120-121; Ylli Drishti, *Ikona shqiptare Shek. XIII-XIX*, Koleksioni i Galerisë Kombëtare të Arteve Tiranë, Tiranë, 2000, faqe 122-123.

¹⁹ Ikona “Shën Kostandini dhe Elena”, është pikturuar nga Mihal Anagnosti dhe daton në vitin 1828. Ikona ka përmasat 38.5x29.5 cm dhe numër inventari nr. 17. Ylli Drishti, *Le icone albanesi XIII-XIX secolo*, Collezione della Galleria nazionale d'Arte Tirana, Tirana, 2000, page 124-125; Ylli Drishti, *Ikona shqiptare Shek. XIII-XIX*, Koleksioni i Galerisë Kombëtare të Arteve Tiranë, Tiranë, 2000, faqe 124-125.

²⁰ Ikona e “Krishtit Pandokrator” vjen nga kisha e Ungjillëzimit, Tiranë. Ajo ka përmasat 105.3x78x3.5 cm. Ikona është e ekspozuar në Muzeun e Artit mesjetar në Korçë me numër inventari 3898. Ikona është pikturuar nga Mihal dhe Dhimitër Anagnosti në vitin 1830. Në ikonë Krishti Pandokrator paraqitet me lavdinë e Tij qiellore. Ai është veshur me rroba të kuqe dhe me tunikën ngjyrë blu. Stihari i Krishtit është i stolisur me motive floreale. Në mes ka lidhur një rrip ngjyrë ari. Krishti bekon me dorën e djathtë dhe mban ungjillin në dorën e majtë. Ungjilli i Shenjtë tregon se Jisu Krishti është mësues për gjithë njerëzimin. Në të është shkruar: “Ejani, të bekuar të atit tim; trashëgoni mbretërinë që u bë gati për ju që nga themelimi i botës. Sepse pata uri dhe më dhatë për të ngrënë, pata etje dhe më dhatë për të pirë, isha i huaj dhe më pritët, isha i zhveshur dhe më veshët, isha i sëmurë dhe ju më vizituat, isha në burg dhe erdhët tek unë” (Mateu 25, 34-37). Në faqen tjetër është shkruar: “Ejani tek unë, o të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju çlodh. Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse jam zemërbutë dhe i përlurur nga zemra, dhe do të gjeni çlodhje për shpirtrat tuaj. Sepse zgjedha ime është e butë dhe barra ime është e lehtë!” (Mateu 11, 28-30). IC XC në pjesën e sipërme të ikonës janë shkronjat e para të emrit Jisu Krisht në greqisht. Të përkthyer në shqip, mund të shkruhen JS KR. Shkronjat në kurorën Ì Ù Í kanë kuptimin “AI QË ËSHTË”. Përkthyer në shqip, mund të shkruhen “JAM”. Ky është emri që Zoti i tregoi Moisiut në Malin e Horebit. Ikona emërtohet: “Krishti mëshirues dhe përdëllimtar”. Në pjesën e poshtme të ikonës është shkruar: “Me dorën e piktorëve të përvojatur Mihalit dhe Dhimitrit, birit të tij, 1830”. Eugenia Drakopoulou, *Icons from the Orthodox Communities of Albania*, Thessaloniki, 2006, page 194-195.

dhe atë të “Shën Mërisë me Krishtin”²¹. Ikonat aktualisht ikonat janë të ekspozuara në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë. Mbi ikonën e madhe të “Krishtit Pandokrator” gjendet mbishkrimi: “Me dorën e piktorëve të përvuajtur Mihalit dhe Dhimitrit, birit të tij, 1830”²². Mendojmë se autorësinë e Mihal Anagnostit kanë edhe ikonat e vogla, të cilat aktualisht janë në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë: Ungjillëzimi i Hyjlindëses, me përmasat 40.7x29.6x3 cm dhe numër inventari 3786; Rreperja e Krishtit, me përmasat 40.6x31x3 cm dhe numër inventari 3788; Zbritja e Krishtit në ferr, me përmasat 41.5x31x3.5 cm dhe numër inventari 3755; Shën Gjon Vladimiri dhe Thaleleo, me përmasat 40.8x30x3 cm dhe numër inventari 3803; Shën Sava, Joan Damaskini dhe Varvara, me përmasat 41x31.3x2.6 cm dhe numër inventari 3815. Në ikonë është data 1829. Shën Naumi, etj.

Në vitin 1829 Mihal dhe Dhimitër Anagnosti kanë pikturuar ikonat e mëdha të ikonostasit të kishës së manastirit të “Gjon Pararendësit” (Bigorskit) në Dibër. Në ikonën e Gjon Pararendësit është mbishkrimi: “Me dorën e Mihal Anagnostit dhe birit të tij Dhimitër nga Samarina”. Në vitin 1830 Mihali dhe Dhimitri pikturuan trapezarinë e manastirit të “Gjon Pararendësit”²³ në Dibër. Gjatë kohës që puninin në manastir në vitin 1832, djali i Mihalit, Dhimitri përqafoi jetën monakale, duke u bërë murg me emrin Daniel. Puna për pikturimin e ikonave dhe të trapezarisë së

²¹ Ikona e Shën Mërisë me Krishtin e realizuar nga Mihal e Dhimitër Anagnosti daton në vitin 1830. Ajo ka përmasat 106x78.5 cm dhe numër inventari 3897. Ikona ka një brerore prej argjendi. Gjithashtu edhe duart e Shën Mërisë janë derdhur në argjend. Ylli Drishti, *Ikona bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri*, Davinci, Tiranë, 2003, faqe 47; Ylli Drishti, *The Byzantine and Post-Byzantine Icons in Albania*, Davinci, Tirana, 2003, page 47.

²² Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 50, faqe 68; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe Kulturë*, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2006, faqe 212; Dhimitër Beduli, *Kodiku i kishës së Shën Prokopit (1818-1922)*, Tiranë 1997, faqe 54; Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, *Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës*, Neraida, Tiranë 2007, faqe 16.

²³ Dimitar Cornakov, *Macedonian monasteries, Malice Makedonska*, Shkup, 1996 faqe 56.

manastirit të “Gjon Pararendësit” në Dibër vazhdoi deri më 1833. Në vitin 1834 Mihal Anagnosti ka pikturuar ikonën e “Ungjillëzimit” në kishën e “Shën Athanasit” në Këqevë. Mbi ikonë është shkruar: “Me dorën e të përulurit piktor Mihal Anagnostit 1834. Katër vjet më vonë, më 1838 Mihali ka pikturuar kishën e “Shën Gjergjit” të Nigritas. Në vitin 1840 Mihal Anagnosti bashkë me birin e tij Nikolla dhe nxënësin Diço Zografë kanë pikturuar kishën e “Shën Gjergjit” në Reçicë në afërsi të Debar. Kjo kishë është një nga metoqet e manastirit të “Gjon Pararendësit” Bigorskit. Më 1842 Mihali bashkë me Nikollën kanë pikturuar kishën e “Shën Dhimitrit” në Bitola (Manastir), si edhe kishën e “Shën Gjergjit” në Resen, më 1844. Në vitin 1842 Mihal Anagnosti ka pikturuar kishën e manastirit të Rilës. Më 1849 Mihal Anagnosti bashkë me Ziso nga Krusheva kanë pikturuar në Treskavec. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi: “Me dorën e piktorëve të përulur Mihal dhe Ziso nga Krushova 1849. Në vitin 1849, biri i Mihalit, Nikolla ka pikturuar ikonën e “Shën Kostandinit dhe Elenës” në ikonostasin e kishës “Lindja e Shën Mërisë” në Elbasan. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi ikonë: “Dora e Nikollës, birit të Mihalit Zografit, nga Krushova, 1849”²⁴.

Krijimtaria e Anagnostëve shquhet për kompozimet me veshje të larmishme dhe të zbukuruar me motive floreale e gjeometrike. Në sfond ata përdorin peizazhe arkitektonike. Ikonat e tyre dallohen nga një plastikë e pasur si edhe nga një pasuri koloristike dhe ornamentale²⁵. Ikonat e tyre janë të pasura me detaje të shumta floreale dhe zoomorfe. Veshjet e përdorura për shenjtorët e tij, janë të pasura me detaje plot ngjyrë dhe formë. Stili i tyre ndërthurret ndërmjet pikturës dhe ikonografisë, sepse nëpër ikona vërrejmë shumë detaje piktoreske. Sapo përballësh me këto vepra

²⁴ Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 58, faqe 72.

²⁵ Kristofor Naslazi, *Influenca e shkollës ikonografike të Korçës te disa piktorë të shek. 19-të*, Monumentet 2002, faqe 108; Kristofor Naslazi, *Influenca e shkollës ikonografike të Korçës te piktorët të shek. XIX Mihal dhe Dhimitër Anagnosti*, 200 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë, 2003, faqe 299-302.

të bien menjëherë në sy tekstilet moderne që janë përdorur. Ngjyrat e përdorura në ikona janë të gjalla. Dominojnë e kuqja, okra dhe bluja. Figurat e shenjtoreve që janë paraqitur në këto ikona, janë më ekspressive. Kulmi i pjekurisë artistike është shprehur në ikonat e “Shën Gjergjit”, “Shën Mërisë me Krishtin” dhe “Krishti Pandokrator”. Në këto vepra stili i tij është përsosur si në pasurimin me detaje të tekstileve edhe me format e shprehura anatomike. Kjo përsosmëri artistike, përkon me vitin 1828, që vëmë re në disa prej ikonave. Ikonat e pikturuara nga Mihal dhe Dhimitër Anagnosti i përkasin artit pasbizantin. Me Mihal dhe Dhimitër Anagnostin mbyllet epoka e artit pasbizantin në Shqipëri²⁶.

Bibliografi

-Andrea Llukani, *Ikonat e Mihal Anagnostit në Muzeun Historik Kombëtar*, Studime Muzeologjike nr. 5, Tiranë 2015, faqe 53-55.

-Andrea Llukani, *Mihal Anagnosti, piktori i fundit i artit pasbizantin në Shqipëri*, Le Radici, Anno 13, n.3, Novembre 2015, pagina 23.

-Andrea Llukani, *Paraqitja e Shën Gjergjit të Janinës me fustanellë shqiptare*, Studime Muzeologjike nr. 6, Tiranë 2016, faqe 70-75.

-Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare*, Dritëhije Nr. 1, Tiranë 2018, faqe 66-87.

-Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, *Thesare të Muzeut Historik Kombëtar*, Tiranë, 2018.

-Dorian Koçi, Skënder Bushi, Andrea Llukani, *Treasuries of National Historical Museum*, Tirana, 2018.

-Dhimitra Lazidhu, Dhimitra Drosaçi, *Manuali i restaurimit*

²⁶ Andrea Llukani, *Mihal Anagnosti, piktori i fundit i artit pasbizantin në Shqipëri*, Le Radici, Anno 13, n.3, Novembre 2015, pagina 23; Andrea Llukani, *Ikonat e Mihal Anagnostit në Muzeun Historik Kombëtar*, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2016.

të ikonave nga Muzeu i Artit Mesjetar Korçë, Selanik, 2008.

-Eugenia Drakopoulou, *Icons from the Orthodox Communities of Albania*, Thessaloniki, 2006.

-*Ikone di Albania, Arte sacra dal XIV al XIX secolo*, Ancona, 2002.

-Kristofor Naslazi, *Influenca e shkollës ikonografike të Korçës të piktorët të shek. XIX Mihal dhe Dhimitër Anagnosti*, 200 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë, 2003, faqe 299-302.

-Nikolaos Hroni Papageorgiou, *To katholiko tis Agias Paraskevis kai o naos tis Metamorfoseos tou Sotiros Samarinas Grebenon*, Kentro Bizantinon Erevnon, Thessaliniki, 2010.

-Theofan Popa, *Piktorët mesjetarë shqiptarë*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1961.

-Theofan Popa, *Icones et miniatures du Moyen age en Albanie, Ikona dhe miniatura mesjetare në Shqipëri*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1974.

-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë 1998.

-Theofan Popa, *Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë, 2006.

-Ylli Drishti, *Ikona shqiptare Shek. XIII-XIX*, Koleksioni i Galerisë Kombëtare të Arteve Tiranë, Tiranë, 2000.

-Ylli Drishti, *Le icone albanesi XIII-XIX secolo*, Collezione della Galleria nazionale d'Arte Tirana, Tirana, 2000.

-Ylli Drishti, *Ikona bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri*, Davinci, Tiranë, 2003.

-Ylli Drishti, *The Byzantine and Post-Byzantine Icons in Albania*, Davinci, Tirana, 2003.

-Ylli Drishti, *Ikona, Koleksioni i Muzeut Historik Kombëtar (Shek.XIV-XIX)*, Konsulent shkencor Andrea Llukani, Botimet Mali Pleshti, Tiranë, 2017.

-Ylli Drishti, *Icons, Colection of the National History Museum (14th-19th centuries)*, Scientific advisor Andrea Llukani, Mali Pleshti, Tirana, 2017.